

KUJDESI PAS OPERACIONIT TE RINOSEPTOPLASTIKES

PARATHENIE

I nderuar pacient, ju lutemi lexoni dhe familjarizohuni me instruksionet para dhe pas, operacionit. Duke i lexuar me kujdes ato, ju -do to arrini rezultatin me te mire te mundshem nga operacioni. Nese gjate leximit ju dalin pyetje, mos hezitoni te komunikoni me kirurgun apo. asistentin dhe te diskutoni pyetjet tuaja ne cdo kohe.

KESHILLAT

- Tre-kater ore pas operacionit ju nuk duhet to ngriheni nga shtrati.
- Mos shfry hundet. Po to jete e nevojshme fshije apo preke hunden lehte me shami thithese.
- Pasi te kete dale mire efekti i 1endes anestetike, ju mund te ushqeheni shpesh e nga pak (qumesht, pije freskuese, kos, supe, akullore). Duhet te evitoni pertypjes e ushqinaeve te forta, sepse mund to levize allcia nga vendi.
- Per 5 dite pas operacionit duhet to merrni antibiotike, sipas keshilles se mjekut.
- Per 10 dite duhet to evitoni mbeshtetjen e hundes ne jastik, pra do te flini ne shpine ose duke mbeshtetur koken ne ane te jastikut.
- Diten mbas operacionit mund te filloni te ushqeheni normalisht, sipas zakonit qe keni.
- Nje deri ne tre dite pas operacionit hiqen tamponet e hundes. Per kete qellim do te lini oren dhe vendtakin me mjekun kirurg apo asistentin.
- Pas heqjes se tamponeve do te filloni te hidhni ne hunde ilacin qe ju ka rekomanduar mjeku (3 here nga 2-3 pika).
- Mveshja e hundes (allcia apo tjetër plast) duhet te ruhet e thate. Hiqet nga dita e 8-12-te.
- Laji dhembet ngadale dhe me farce te bute. Menjano levizjet e buzes se sipeme ne menyre qe te mos levize hunda.
- Menjano bisedat telefonike te zgjatura ose te teperta, si dhe aktivitetet shoqerore sepaku 10-14 dite.
- Ju mund te lani fytyren me kujdes pa lagur mveshjen e hundes. Mund te beni dush pa lagur koken.
- Menjano te qeshuren, ngerdheshjen dhe levizjet e teperta te fytyres deri sa te hiqet allcia.
- Mos i laj floket deri sa te hiqet allcia, po qe se nuk keni njeri qe t' ju laje.
- Menjano aktivitetin fizik te tepert. Menjano ushtrimet ku perfshihen aktivitetet atletike dhe marredheniet seksuale.
- Vish rroba qe hiqen perpara ose prapa (qe nuk hiqen nga koka) per dy jave. Menjano veshjet sintetike dhe T-shirt.
- Gjithesesi I interesuari qe i nenshtrohet nderhyrjes se rinoplastikes eshte i afte per pune pas disa javesh. Per dy jave nuk duhet te udhetoje me avion. Nje muaj pas operacionit duhet te rikontrollohet. Per nje muaj e gjysem nuk duhet te ekspozoje fytyren ne diell. Per 3 rnuaj duhet te ruaj hundën nga goditjet.
- Se fundi rezultati final eshte subjektiv, qe domethene hunda e perftuar per dike eshte terheqese, ndersa per nje tjetër nuk eshte terheqese, Sidoqofte, rezultat i mire . eshte perfitimi I nje pamje normale, ku te gjitha pjeset e fytyres jane ne harmonime njera tjetren.
- Te dhenat statistiko-e jane marre nga Akademia Amerikane e Kirurgjise Plastike Te Fytyres, ndersa, informacioni eshte bazuar mbi Compendium 2000 te Akademise Amerikane te Otolarinologjise-Kirurgjise kokes dhe qafes.

Ju lutemi, pasi te jeni informuar per nderhyrjen, ne rast se do te jeni dakord, duhet te firmosni.

Kirurgu

I interesuari